



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 165 Datë 28.05.2020

**PËR
PËRMBUSHJEN, NGA KANDIDATI, TË KRITEREVE DHE KUSHTEVE TË
KANDIDIMIT, PËR T’U KOMANDUAR SI PEDAGOG I BRENDSHËM, NË
DEPARTAMENTIN E FORMIMIT FILLESTAR, TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 99 datë 26.02.2020 të KLGJ-së për “Hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës”, në Vendimin nr.142 datë 22.04.2020 të KLGJ-së për “Rifillimin e procedurave administrative të pezulluara për shkak të parandalimit të përhapjes së Covid-19”, në Vendimin nr. 159 datë 15.05.2020 të KLGJ-së, mbi “Opinionin për kandidaten znj. {...} në procedurën e komandimit si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e plotësisimit të kushteve dhe kriterëve për komandim (*përveç kriterit të mësimdhënies që do të vlerësohet nga Shkolla e Magjistraturës*), të kandidatës, gjyqtares {...}, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.
2. Dërgimin e emrit të gjyqtares {...} Shkollës së Magjistraturës së bashku me praktikën dokumentare të paraqitur prej saj dhe Opinionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me këtë kandidatë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR